



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
Fakulteti Ekonomik

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Dekani  
Prof. Asoc. Dr. Halil KUKAJ

Nr. i ref. 01-256

Prizren, më 28.06.2021

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**Ndërmjet**

**FAKULTETIT EKONOMIK**

**dhe**

**E M CORPORATION SH.P.K.**

*E lidhur më datë: 10.04.2021 ndërmjet:*

**FAKULTETIT EKONOMIK DHE E M CORPORATION SH.P.K.**

Universiteti i Prizrenit "Ukshin HOTI" rr." Shkronjave" nr. 1 Prizren

**Përfaqësuar nga Dekani: Prof. Asoc. Dr. Halil KUKAJ**

(Tani e tutje do tu referohemi si "Palë")

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) e lidhur në mes të E M CORPORATION SH.P.K. dhe Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin HOTI" Prizren e cila ka të bëjë me mbajtjen e praktikës profesionale të studentëve të Fakultetit Ekonomik.

**Neni 2**

Fakultetit Ekonomik i Universitetit "Ukshin HOTI" në Prizren ka drejtimet si më poshtë ku studentët kanë nevojë për mbajtjen e praktikës profesionale në organizatën tuaj.

Nr.	Fakulteti	Drejtimi	Programi	
1.	Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	Bachelor	
		Administrim Biznesi	Bachelor	
		Kontabilitet dhe Auditim	Master	
		Administrim Biznesi	Master	

E M CORPORATION SH.P.K. është e obliguar që studentëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin HOTI" në Prizreni tu ofrojnë kushte për mbajtjen e praktikës profesionale në afat prej 15 ditë.

### Neni 3

Studentëve që studiojnë në programet e lartshënuara fakulteti është i obliguar që për studentët që kanë arritur me i dhanë provimet e nevojshme dhe që duhet të mbajnë praktikën profesionale t'i sistemoj dhe tu jap dokument zyrtar se ata mund të vazhdojnë praktikën në ndërmarrjen e lartshënuar për periudhën e caktuara kohore prej 15 ditë pune gjegjësisht në afat prej 60 orë.

### Neni 4

Ndërmarrja është e obliguar që studenteve praktikant tu krijojë kushte dhe ambient pune që studentet e Fakultetit Ekonomik të mund të ushtrojnë profesionin e tyre për kohën sa janë në praktikë në ndërmarrjen e lartë cekur.

### Neni 5

Ndërmarrja është e obliguara që pas përfundimit të praktikës studenteve tu japin vërtetim me shkrim se kanë mbajtur praktikën profesionale në periudhën e caktuar në organizatën e tyre.

### Neni 6

Ndërmarrjet sipas nevojave dhe kërkesave mund të angazhojnë pedagogë të fakultetit Ekonomik për kryejnë e ekspertizave profesionale. Kushtet e bashkëpunimit për ekspertiza do të definohen me kontratë.

### Neni 7

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhe tre vjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi edhe për periudha tjera kohore.

### Neni 8

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në 2 kopje identike në gjuhën shqipe. Të gjitha kopjet kanë të njëjtën force ligjore dhe janë të vlefshme për të gjitha palët nënshkruese.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.



Përfaqësuar nga:



Prizren, 2021